



ORGANISATION
INTERNATIONALE DE
LA FRANCOPHONIE

Pranvera e
Frankofonisë

17 deri
24 mars



Printemps
de la
Francophonie
en
Albanie
2016



*KONFERENCË PËR SHTYP
E MARTË 15 MARS – ora 11:00
Ministria e Kulturës
Salla Tefta Tashko Koço*

Objektivat e Pranverës së Frankofonisë janë promovimi i vlerave të frankofonisë:

- Gjuha frënge dhe diversiteti kulturor dhe gjuhësor;
- Paqja, demokracia dhe të drejtat e njeriut;
- Mbështetja e edukimit, formimit, arsimit të lartë dhe punës kërkimore shkencore ;

Nga e enjtja 17 mars deri të enjten 24 mars, një sërë eventesh do të organizohen në Tiranë dhe në të gjithë Shqipërinë:

- Shfaqje filmash,
- Ekspozita,
- Konferenca,
- Koncerte,
- Pjesë teatrore,
- etj...

PLANNING

E enjte 17 mars

Pritja zyrtare

13.00 – Ministria e Punëve të Jashtme

Çelja e ekspozitës « Vizatim i lirë » (Dessins en liberté)

17.30 – Center for Openness and Dialogue

Konferencë-debat « Vlerat e frankofonisë kundër barbarisë » Si të mbajmë gjallë frymën e iluministëve sot në Evropë dhe në Shqipëri ?

19.00 – Salla Liria – Universiteti i Tiranës

E premte 18 mars

Çelja e ekspozitës « Les Acadiens d’la Baie »

18.00 – DitArt Culture Center

Koncerti « Meetin’Moa »

19.00 – Tulla Culture Center

E shtunë 19 mars

Pjesa teatrore për fëmijë « Cuit sans sauce »

11.00 - Teatri i Metropolit

Shfaqja e filmit « Vis-à-vis »

Nga Nevio Marasovic (Kroaci)

19.00 – Akademia e Filmit dhe Multimedias Marubi

E djelë 20 mars

Konkursi i këngës franceze

14.00 – 17.00 – Universiteti i Arteve, Tiranë

Shfaqja e filmit « T'i mbijetosh jetës (teori dhe praktikë) »

(Survivre à sa vie (théorique et pratique))

nga Jan Svankmajer

(Rep. Çeke)

18.00 – Akademia e Filmit dhe Multimedias Marubi

E hënë 21 mars

Forumi ekonomik frankofon

9.00 - 15.00

Shfaqja e filmit « 4 muaj, 3 javë, 2 ditë » (4 mois, 3 semaines, 2 jours)

nga Christian Mungiu (Rumani)

19.00 – Akademia e Filmit dhe Multimedias Marubi

Fushata « Goût de France »

Restorant Floga (Tiranë), Marchesi (Mullet), Life Gallery (Korçë), Shën Gjergji (Korçë),

Rapsodia (Shëngjin)

Darkë

E martë 22 mars

Koncerti « Christian Tschanz » (pop-rock/Zvicër)

19.00 – Teatri eksperimental

E mërkurë 23 mars

Takim me Eric-Emmanuel Schmitt

Me rastin e botimit në shqip të librit « *Ulysse from Baghdad* »

11.30 - Salla UNESCO e Muzeut Historik Kombëtar

Teatër « Zoti Ibrahim dhe lulet e kuranit »

Nga Eric-Emmanuel Shmitt, interpretuar nga Mirush Kabashi

19:00 – Teatri Eksperimental




FOKUS

Çelja e ekspozitës « Vizatim i lirë » (Dessins en liberté)

Organizuar nga Aleanca Franceze e Tiranës dhe Instituti Francez.

Pas sulmeve kundër gazetës satirike « Charlie Hebdo », kjo ekspozitë u krijua nga Instituti Francez në bashkëpunim me gazetën javore « Courrier International ». Përmes shumë vizatimeve të shtypit, ajo ilustron mënyrën se si liria e shtypit ushtrohet në botën e ditëve të sotme.



Konferencë-debat « Vlerat e frankofonisë » Si të mbajmë gjallë frymën e Iluministëve sot në Evropë dhe në Shqipëri?

Të ftuar: Znj. Eriona Tartari, Doktor në letërsi në Universitetin e Mopeliesë-s, Z. Radu Toma, filozof dhe Drejtor i Shkollës së Doktoraturës Frankofone të Shkencave Sociale të Bukureshtit, si dhe Benoît Falaize, historian, i ngarkuar me studime mbi « Laicitetin dhe vlerat e Republikës » nga Ministria e Edukimit Kombëtar.

Shkencëtarë dhe intelektualë të ndryshëm frankofonë do të mblidhen në Universitetin e Tiranës për të diskutuar mbi vlerat që ne ndajmë dhe për të analizuar nëse shpirti i iluminizmit është akoma i gjallë në Evropë dhe në Shqipëri.

Filozofët iluministë kudo në Evropë mbrojtën lirinë, tolerancën, progresin, mirëqenien individuale dhe arsyen kundër çdo lloj forme shtypëse.

Konferencë në gjuhën frënge e shoqëruar me përkthim simultan në shqip.

Çelja e ekspozitës « Les Acadiens d'la Baie »

Organizuar nga EkphrasisStudio, në Qendrën kulturore Ditart

"Les Acadiens d'La Baie", një ekspozitë në Qendrën kulturore DitArt, prezanton akadianët frankofonë të Gjirit të Shën Mërisë, në Skocinë e Re, përmes historisë së tyre, gjuhës, kulturës dhe muzikës. Akadianët janë kolonia e parë evropiane që mbërriti në Kanada duke filluar nga viti 1604. Pasardhësit e tyre janë vendosur në Gjirin e Shën Mërisë më 1768-ën dhe kanë ndenjur aty që prej asaj kohe.

Koncert « Meetin'Moya » (Këngë/Austri)

Organizuar nga Ambasada Austriake

Moa është emri i një lloj zogu sot në zhdukje, por është gjithashtu emri i një artisteje, tek e cila muzika gjendet mes kompozimit, këngës franceze dhe varietesë. E ardhur nga komuniteti i muzikantëve "Mildenburg" të Salsburgut, Hemma Treppo luan në skenë që prej dhjetë vitesh. Kompozimet e saj gjejnë tonin e saktë dhe meloditë që i përshtaten më shumë zërit të saj aq të veçantë, herë i zymtë e ëndërrimtar, herë fëmijënor e i gjallë.




Teatër dhe akrobaci « Cuit sans sauce »

Organizuar nga Aleanca Franceze e Tiranës

Nga kompania Miam-Miam

me aktoret Agathe Berdnarz dhe Vicky Tiefenauer dhe muzikantin-teknik Thibaud Ader.



Spektakli "Cuit sans sauce" është një spektakël teatri dhe akrobacie kulinare për fëmijë dhe të rritur ! "Dy femra, dy bashkëpunëtore. Ato kanë ardhur për të na treguar një recetë gatimi, por jo një recetë çfarëdo: bëhet fjalë për një recetë të veçantë, atë të gjyshes, më të shijshmen, më të jashtëzakonshmen, më të shkëlqyerën. A do t'i rrëmbejë vala ato? Cila do të gatuajë shoqen? Cila do të vihet në lojë?"

Nga shoqëria Miam-Miam, me aktoret Agathe Bednarz dhe Vicky Tiefenauer dhe muzikantin-
teknik Thibaud.

Film « Vis-à-vis »


Titulli original: « Vis-à-vis »

Vendi: Kroaci

Regjisor: Nevio Marasović

Me: Antonio Parac, Karlo Maloca, Vanja Markovinovic

Viti: 2013



Një regjisor po punon mbi një film të ri. Ai fton aktorin kryesor në ishullin e izoluar të Visit për të punuar së bashku mbi skenarin. Të bllokuar në këtë izolim gjatë periudhës së dimrit, këta dy personazhe vihen përballë frikës së tyre, e cila do të ndërthuret me temën e filmit në një mënyrë të cuditshme.

Konkursi i këngës franceze

Organizuar nga Aleancat Franceze e Shqipërisë dhe Ambasada e Francës në Tiranë

Ejani në Universitetin e Arteve të Tiranës për të marrë pjesë në finalen e madhe të konkursit të këngës franceze. Kandidatët janë përzgjedhur nga Aleancat Franceze të Elbasanit, Durrësit, Korçës, Shkodrës dhe Tiranës: Vetëm më të mirët marrin pjesë në finalen! Më i/e miri/a do të fitojë një fundjavë në Paris!

Film « Survivre à sa vie (théorie et pratique) »

Titulli origjinal: Přežít svůj život

Vendi: Republika Çeke

Regjisor: Jan Švankmajer

Me: Václav Helšus, Klára Ssová, Zuzana Kronerová

Kohëzgjatja: 109 Minuta

Viti: 2010



Evgjeni bën një jetë të dyfishtë, të ndarë mes botës reale dhe çasteve ëndërrimtare. Një ditë, shkon tek një psikiatër, i cili merr përsipër të interpretojë ëndrrat e tij dhe zbulon fëmijërinë e tij prej jetimi.

Film në gjuhën çeke me titra në frëngjisht.

Forumi ekonomik frankofon

Organizuar nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Francë-Shqipëri, Agjencia Universitare e Frankofonisë dhe Universiteti i Tiranës

Gjatë paradites do të zhvillohen konferenca, ku do të marrin fjalën përfaqësues të Agjencisë Universitare të Frankofonisë dhe do të flitet në lidhje me Procedurën e studimeve jashtë vendit që aplikojnë ambasadat, Shërbimet ekonomike të ambasadave, Campus France dhe Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Francë-Shqipëri.

Gjatë pasdites do të zhvillohen takime individuale mes studentëve dhe operatorëve ekonomikë.

Fushata gastronomike « Goût de France »

Të hënën më 21 mars, shumë restorante nga mbarë bota do të bëhen bashkë për të shërbyer një menu sipas traditës së gastronomisë franceze. Pesë restorante në Shqipëri e kanë fituar të drejtën për të marrë pjesë në këtë eveniment:

Restorant « Floga » - Tiranë me shef Artemi Stefanidhin ;
Restorant « Marchesi » - Mullet me shef Gëzim Musliakën ;
Restorant « Life Gallery » - Korçë me shef Desart Follajn ;
Restorant « Shën Gjergji » - Korçë me shef Admir Burimin;
Restorant « Rapsodia » - Shëngjin me shef Alfred Markun.

Koncerti « Christian Tschanz » (pop-rock/Zvicër)

Organizuar nga Ambasada Zvicerane


Christian Tschanz do t'ju surprizojë me një ndërthurje mes muzikës dhe fjalëve me shumë kuptime, e cila nuk kalon pa u vënë re. Kompozimet orkestrale aq të pasura alternohen me pjesë power rock, me balada të mrekullueshme, me këngë pop-rock me arranjime të përpunuara dhe një instrumentim shumë i thjeshtuar. Kompozimi është shumë i punuar, sepse artisti i kushton shumë rëndësi pjesëve që luan. Fjalët autentike që i bashkohen zërit shprehës dhe melodik të Christian Tschanz të rrëqethin. Albumi është plot energji dhe gëzim, kënaqësia e të luajturit është kudo. Muzika dhe fjalët do të arrijnë të prekin edhe ata që nuk i kuptojnë pjesët e kënduara në frëngjisht.



Takim me Eric-Emmanuel Schmitt

Me rastin e botimit në shqip të librit « Ulysse from Bagdad »

Me rastin e botimit të librit « Ulysse from Bagdad », i përkthyer në shqip, Ambasada e Francës dhe Botimet Toena bëhen bashkë në organizimin e një takimi ndërmjet Eric-Emmanuel Schmitt dhe publikut të tij shqiptar.



Konferencë në gjuhën frënge e shoqëruar me interpretim simultan në shqip.

Teatër “Zoti Ibrahim dhe lulet e Kuranit”

Përshtatja e romanit të Eric-Emmanuel Schmitt
Interpretuar nga Mirush Kabashi

“Zoti Ibrahim dhe lulet e Kuranit” është autobiografia fiktive e jetës së një qytetari nga Parisi, prindërit e të cilit u ndanë dhe ai jeton tek i ati. Momo, 11 vjeç mbyllet në vetvete. Ka vetëm një shok, Z. Ibrahim, shitësin turk të ushqimoreve dhe filozof të rrugës Blu.

E luajtur në shqip me titra në frëngjisht.